




Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, Mars 2010

Rr. Armend Daci Nr. 1
Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (38) 240 252

Fax: +381 (38) 245 844

E-mail: ICMM@kosovo-mining.org

Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	2
LISTA E FIGURAVE.....	4
LISTA E SHTOJCAVE TË BASHKANGJITURA:	5
SHKURTESAT:	6
1. PARATHËNIE.....	7
2. PËRGJEGJËSITË DHE FUNKSIONET E KPMM-se	8
3. ORGANIZIMI I KPMM-së.....	9
4. AKTIVITETI I KPMM-SË PREJ THEMELIMIT DERI NË FUND TË VITIT 2008.....	11
5. AKTIVITETET E KPMM-SË PËR VITIN 2009	15
6. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË INSPEKTORATIT	27
7. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË GJEOLGJISË	37
8. PROJEKTET 2009	44
9. FINANCAT.....	54
10. AKTIVITETET E TJERA	62
11. PROBLEMET NË SEKTORIN MINERAR	64
12. SYNIMET PËR TË ARDHMEN	66

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Licencat dhe Lejet e lëshuara nga KPMM, nga viti 2005-2008	11
Tabela 2: Buxheti i KPMM-së nga viti 2005-2008	12
Tabela 3: Buxheti i KPMM-së i aprovuar dhe shpenzuar viti 2005-2008	13
Tabela 4: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2009	15
Tabela 5: Licencat e lëshuara të hulumtimit gjatë vitit 2009.....	17
Tabela 6: Licencat e shfrytëzimit të lëshuara në vitin 2009.....	20
Tabela 7: Lista e lejeve të veçanta të lëshuara gjatë vitit 2009.....	23
Tabela 8: Licencat/lejeve e lëshuara nga KPMM sipas viteve dhe llojit të licencave/lejeve ..	26
Tabela 9: Lista e punëtorëve të certifikuar sipas minierave	28
Tabela 10: Lista lëndimeve gjatë vitit 2009	28
Tabela 11: Lista e shpërblimeve ilegale	32
Tabela 12: Kompanitë ilegale të shfrytëzimit të gurëve gëlqerorë, rërës dhe zhavorrit gjatë vitit 2009	35
Tabela 13: Rezervat e shfrytëzuara nga kompanitë gjatë TM1, TM2, TM3, TM4 2009	37
Tabela 14: Prodhimtaria e mineraleve ndërtimore dhe industriale 2005 - 2009.....	38
Tabela 15: Aprovimi i buxhetit të vitit 2009.....	54
Tabela 16: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2009, i shprehur në përqindje.....	55
Tabela 17: Buxheti i shpenzuar në Mallra dhe Shërbime në vitin 2009	55
Tabela 18: Paraqitja e shpenzimeve sipas kategorisë ekonomike (Komunali)	57
Tabela 19: Paraqitja e shpenzimeve sipas kategorisë ekonomike (Subvencione)	58
Tabela 20: Paraqitja e shpenzimeve kapitale.....	58
Tabela 21: Obligimet e paguara për vitin 2009	60
Tabela 22: Faturat e lëshuara dhe të paguara në vitin 2009.....	61

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Organogrami i KPMM-së.....	10
Figura 2. Licencat dhe Lejet e lëshuara nga KPMM nga viti 2005-2008.....	11
Figura 3. Paraqitja grafike e buxhetit të aprovuar ne vitet 2005-2008.....	13
Figura 4. Paraqitja grafike e buxhetit të aprovuar dhe shpenzuar nga vitet 2005-2008.....	14
Figura 5. Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2009.....	16
Figura 6. Harta e licencave të hulumtimit.....	19
Figura 7. Harta e licencave të shfrytëzimit.....	22
Figura 8 Harta e licencave për punë të posaçme.....	25
Figura 9 Licencat/lejeve e lëshuara sipas viteve.....	26
Figura 10. Prodhimtaria e mineraleve ndërtimore për vitin 2009.....	38
Figura 11. Paraqitja grafike e prodhimit të mineraleve ndërtimore 2005 - 2009.....	39
Figura 12. Prodhimi i gëlqerorëve sipas viteve 2005 – 2009.....	39
Figura 13. Planifikimi dhe realizimi i prodhimit për gëlqerorë 2005 – 2009.....	39
Figura 14. Prodhimi i rërës dhe zhavorrit sipas viteve 2005 – 2009.....	40
Figura 15. Planifikimi dhe realizimi i prodhimit për rërë dhe zhavorr 2005 - 2009.....	40
Figura 16. Prodhimi i xehes së Nikelit 2007 - 2009.....	41
Figura 17. Prodhimtaria e xehes së Pb-Zn 2005 – 2009.....	41
Figura 18. Pamje nga Miniera e Linjtit ne KEK.....	42
Figura 19. Prodhimi i linjtit 2004 – 2009.....	42
Figura 20. Harta e resurseve minerale të Kosovës – plansheti i Volljakut si rezultat i rlevimit 1:25000.....	45
Figura 21. Harta e resurseve minerale të Kosovës – plansheti i Kramovikut si rezultat i rlevimit 1:25000.....	46
Figura 22. Hartë vështruese e zonave të mbrojtura minerare të mineraleve ndërtimore.....	48
Figura 23. Hartë vështruese e Zonave të mbrojtura minerare të mineraleve metalike dhe industriale.....	49
Figura 24. Hartë vështruese e zonave të mbrojtura minerare të hidrokarbureve të ngurta (linjiteve).....	50
Figura 25. Hartë vështruese e zonave të interesit.....	51
Figura 26. Aprovimi i buxhetit të vitit 2009.....	54
Figura 27. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar 2009.....	57
Figura 28. Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar 2009.....	57
Figura 29. Paraqitja e shpenzimeve sipas kategorisë ekonomike (Subvencione).....	58
Figura 30. Paraqitja e shpenzimeve kapitale.....	59
Figura 31. Pamje nga Gjeo-databaza e KPMM-se.....	63

LISTA E SHTOJCAVE TË BASHKANGJITURA:

1. Lista e të gjitha licencave valide.
2. Lista e Tantiemave

SHKURTESAT:

ANFO	Ammonium nitrate-fuel oil
ArcMap	Është pjesë e modulit të GIS-it
ArcSDE	është RDBMS (Related Database Management System)
ESRI	Environmental Systems Research Institute
GDK	Gjeo Databaza e Kosovës
GIS	Geographic Information System
GUI	Graphic User Interface
IT	Information Techmology
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Kosovo Force
KPMM	Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
Microsoft SQL Server 2000	Sistem Informativ
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PSPP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SIM	Sistemi Informativ i Menaxhimit
UNMIK	United Nations Mission i Kosovo
VB. Basic. NET	Aplikacion

1. PARATHËNIE

Minierat e Kosovës në veçanti dhe të rajonit në përgjithësi përmes metaleve të nxjerra nga ato i kontribuuan zhvillimit material të kësaj pjesë të botës, e cila pati fatin të jetë e rrahur nga erërat më të ashpra politike si nga jugu, veriu, lindja dhe perëndimi. Se këto miniera ishin bazë e zhvillimit të racës njerëzore mund të konkludohet nga monedhat e gjetura me vjetërsi që nga shekulli i shtatë para epokës sonë, do të thotë të krijuara para 27 shekujsh.

Komisioni për miniera dhe minerale me moton; mbështetja në ligjin, për ligjin dhe sipas ligjit, qasje kjo e cila e arsyeton dhe siguron ekzistencën e tij. Pra ligji është mburoja e tij për aq sa i përmbahet dhe i shërben atij, por edhe shpata e Demokleut e cila qëndron në duart e Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe i monitoruar prej Qeverisë dhe klientëve, në rastin konkret investuesve dhe pronarëve të licencave profesionale.

Duke iu mbështetur ligjit, KPMM e krijon sigurinë dhe vlerën e dokumentacioneve të lëshuara për hulumtimin e pasurive minerare, të quajtura licenca (ngjashëm me tapitë), për punën me pasuritë minerare, për sigurinë dhe mbrojtjen në punë, por edhe për sasinë e mineralit të nxjerrura, qoftë ai metalik, material ndërtimor ose burim energjie. Për njerëzit e autorizuar për punë në lëminë e xehetarisë, gjeologjisë për kryerjen e punëve me përgjegjësinë ma të lartë profesionale duke filluar që nga projektimet etj,

Komisioni posedon personelin profesional me përvojën më të gjatë në prodhimtarinë e drejtpërdrejt të xehetarisë, të hulumtimeve gjeologjike, me kualifikimet superiore profesionale (doktor shkencash dhe gjenerata të reja, të sofistikuar në fushat elektronike dhe në krijimin e regjistrimit të të dhënave digjitale).

Përmes një baze e të dhënave, të fuqishme, në të cilën janë të regjistruara të gjitha të dhënat ekzistuese për pasuritë minerare të Kosovës, përmes të një materiali fizik të deponuar në arkivin e komisionit e të cilat vazhdojnë të zgjerohen përmes projekteve me firmat botërore, KPMM ruan informacionet e duhura për këtë sektor të rëndësishëm. Ndërkaq me ueb-faqen zyrtare ofron qasjen e qytetarëve në dokumentet zyrtare dhe në punën e përgjithshme të KPMM-së.

Jo rastësisht komisioni i ka komplimentet më të mira për bazën e të dhënave, të fuqishme, nga ekspertët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve tjera perëndimore, sidomos në konferencë Mines and Money në Londër më 2006.

Përmes fjalës magjike të minatorëve “me fat “ dhe dëshirës që kjo fjalë magjike ta përcjell edhe punën e Parlamentit dhe shtetit të Kosovës.

Me Fat!

2. PËRGJEGJËSITË DHE FUNKSIONET E KPMM-se

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-081 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë, Nenin 4, përkatësisht 2.3, KPMM i dorëzon raporte të rregullta Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me të gjitha aktivitetet e veta, duke përfshirë edhe çështjet e personelit, organizimin dhe çështjet administrative.

KPMM rregullon dhe mbikëqyrë:

- (a) Hulumtimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë, në pajtim me ligjin në fuqi;
- (b) Shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimet e shfrytëzimit të minierave dhe zvogëlimin e ndikimit të veprimeve të shfrytëzimit në mjedis;
- (c) Zbatimin e standardeve ndërkombëtare për veprimet në miniera dhe në gurore;
- (d) Sigurinë gjatë veprimeve të nxjerrjes së mineraleve dhe në objektet e përpunimit në pajtim me ligjin në fuqi dhe me standardet e nevojshme për sigurinë, dhe
- (e) Pajtueshmërinë e përgjithshme të veprimeve për shfrytëzimin e minierave me kushtet e licencave, marrëveshjeve për leje dhe të instrumenteve të tjera për autorizim.

Funksionet e KPMM-së janë:

- (a) Zbatimi i politikave dhe strategjisë zhvillimore të sektorit minerar të përgatitura nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
- (b) Lëshimi, bartja, pezullimi dhe tërheqja e lejeve dhe licencave për hulumtim dhe shfrytëzim dhe për punë të posaçme;
- (c) Lëshimi, bartja, pezullimi dhe tërheqja e lejeve dhe licencave lidhur me shfrytëzimin e lëndëve plasëse në veprimtarinë minerare;
- (d) Kryerja e hetimeve lidhur me aksidentet që ndodhin në miniera dhe aktivitete të ndryshme minerare dhe veprimet e domosdoshme që nevojiten si pasojë e kësaj;
- (e) Krijimi dhe mirëmbajtja e Bazës së të Dhënave për titullarët e mineraleve dhe të drejtave për shfrytëzimin e resurseve minerale, dhe
- (f) Ofrimi i ndihmës teknike Qeverisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë.

Me 31.07.2009 është bere dorëzimi i çelësave të depove të eksplozivit nga KPMM tek MPB, qe nënkupton edhe bartjen e përgjegjësisë për depot e eksplozivit komercial ne Kosove. Ky transfer është bërë ne përputhje me ligjin për përdorim civil te eksploziveve.

3. ORGANIZIMI I KPMM-së

3.1 Bordi

Komisioni përbëhet nga Bordi drejtues (“Bordi”), i cili i ka pesë anëtarë.

Të gjitha kompetencat e komisionit i ka Bordi Qeverisës i KPMM-së. Bordi mund t’i delegojë funksione të caktuara Drejtorit, përveç atyre që i janë dhënë në pajtim me ligjin për themelimin të KPMM-së.

Bordi i KPMM-së është i obliguar të takohet së paku një herë në muaj për shqyrtimin e çështjeve për të cilat KPMM është përgjegjëse. Bordi i KPMM-së, përveç takimeve të rregullta, me kërkesë të Drejtorit apo të ndonjërit prej anëtarëve të bordit organizon edhe takime tjera. Anëtarët e bordit janë në marrëdhënie të rregullt pune në KPMM dhe realizojnë detyra të përditshme në përputhje me ligjin në fuqi.

Për marrjen e një vendimi në bord, Drejtori dhe stafi tjetër profesional përgatisin dhe shqyrtojnë kërkesat veç e veç sipas departamenteve, pastaj përmes takimeve të para-bordit bëhet seleksionimi i kërkesave që plotësojnë kriteret për t’u përcjellë për bord, në përputhje me ligjet në fuqi.

3.2 Drejtoria dhe Stafi Tjetër Profesional

KPMM për vitin 2009 ka pasur të aprovuara 79 pozicione për staf. Drejtori dhe Zëvendësdrejtori janë përgjegjës për të gjitha çështjet ekzekutive brenda KPMM-së. Ata bëjnë organizimin e takimeve të bordit, përgatitjen e raporteve sipas kërkesave për mbledhjen e bordit dhe merren me ekzekutimin e vendimeve të bordit.

Ne kuadër të KPMM-së funksionojnë këto Departamente:

- Inspektorati,
- Gjeologjia,
- Gjeodezia,
- GIS,
- Zyra Ligjore
- Financat,
- Administrata,
- Prokurimi,
- IT, dhe
- Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Më poshtë kemi paraqitur strukturën Organizative të KPMM-së për vitin 2009




Figura 1. Organogrami i KPMM-së

4. AKTIVITETI I KPMM-SË PREJ THEMELIT DERI NË FUND TË VITIT 2008

Më 16 qershor të vitit 2008 është dekretuar Ligji Nr. 03/L-081 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi Themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet, dhe nga ajo datë KPMM i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Nga viti 2005-2008 KPMM ka **lëshuar 394 licenca** dhe leje, siç janë pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela 1: Licencat dhe Lejet e lëshuara nga KPMM, nga viti 2005-2008

Licencat dhe Lejet e lëshuara nga KPMM nga viti 2005-2008					
Lloji i licencës	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Gjithsej
Licencat për hulumtim	10	14	27	74	124
Licencat për shfrytëzim	33	49	55	38	175
Lejet speciale	9	15	37	33	95
Gjithsej	52	78	119	145	394




Figura 2. Licencat dhe Lejet e lëshuara nga KPMM nga viti 2005-2008

Gjatë kësaj periudhe kohore KPMM ka kryer aktivitetet e nevojshme me qëllim të plotësimit të të dhënave themelore lidhur me resurset minerale të Kosovës, më se të domosdoshme për realizimin e hulumtimeve gjeologjike të mëtejme, mbështetjen e investitorëve potencialë dhe

përgatitjen e resurseve minerale për treg. Projektet kryesore që janë kryer gjatë kësaj periudhe janë:

- Baza Gjeologjike e të Dhënave
- Plani i Guroreve të Kosovës
- Hartat Gjeologjike Tematike të Kosovës
- Sistemi i Sigurimit të Eksplozivëve
- Matjet Ajrore Gjeofizike
- Laboratori Gjeologjik
- Website i KPMM-së (www.kosovo-mining.org)

Buxheti i KPMM-së nga viti 2005-2008 ka qenë:

Tabela 2: Buxheti i KPMM-së nga viti 2005-2008

Nr. Rendor	Kategoria ekonomike	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008
1	Paga dhe Mëditje	169,000.00€	167,039.00 €	249,782.00 €	312,948.00 €
2	Mallra dhe Shërbime	796,000.00 €	489,753.00 €	456,390.00 €	368,885.00 €
3	Komunali		30,000.00 €	30,000.00 €	30,000.00 €
4	Kapitale	1,000,000.00 €	1,115,000.00 €	1,167,000.00 €	120,000.00 €
	Totali	1,965,000.00 €	1,801,792.00 €	1,903,172.00 €	831,833.00 €




Figura 3. Paraqitja grafike e buxhetit të aprovuar ne vitet 2005-2008.

Tabela 3: Buxheti i KPMM-së i aprovuar dhe shpenzuar viti 2005-2008

Nr. Ren.	Vitet	Buxheti i Aprovuar	Buxheti i Shpenzuar	Ndryshimi	%
1	2005	1,965,000.00 €	1,866,910.89 €	98,089.11	95%
2	2006	1,801,792.00 €	1,730,909.46 €	70,882.54 €	96%
3	2007	1,903,172.00 €	1,774,981.76 €	128,190.24 €	93%
4	2008	831,833.00 €	784,640.47 €	47,192.53 €	94.33%




Figura 4. Paraqitja grafike e buxhetit të aprovuar dhe shpenzuar nga vitet 2005-2008.

5. AKTIVITETET E KPMM-SË PËR VITIN 2009

5.1 Licencimi

Gjatë vitit 2009 janë mbajtur 10 takime te bordit ne te cilat janë shqyrtuar 161 kërkesa për licenca dhe leje, ku 73 kane qene kërkesa para vitit 2009 ndërsa 88 kane qene kërkesa te vitit 2009. Gjate këtij viti kemi pranuar gjithsej 140 kërkesa për licenca dhe leje, prej tyre për licenca te hulumtimit kanë qenë 93, licenca te shfrytëzimit 47 dhe leje për pune te posaçme 28, qe shumica nga ato nuk kane mundur te procedohen për shkak te mungesës se bordit pas muajit korrik, sepse me 28 korrik ju ka skaduar mandati tre anëtarëve te bordit, çka ka pamundësuar organizimin e takimeve për vendimmarrje te bordit.

KPMM gjatë vitit 2009 ka proceduar gjithsej 162 kërkesa, prej tyre:

- Kërkesa për Licenca shfrytëzimi – 45,
- Kërkesa për Licenca hulumtimi – 88.
- Kërkesa për Leje për punë të posaçme – 28.

Pas procedimit të të gjitha aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi janë lëshuar 80 Licenca dhe 20 Leje për punë të posaçme. Nga aplikacionet janë refuzuar 26 kërkesa ndërsa pjesa tjetër janë shtyrë për te plotësuar dokumentacionin, figura e mëposhtme, dhe atë:

Tabela 4: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2009

Nr. Rendor	Përshkrimi I vendimit	Numri I vendimeve
1	Licenca shfrytëzimi	27
2	Licenca hulumtimi	53
3	Leje për punë të posaçme	20
4	Kërkesa te refuzuara	26
5	Kërkesa te shtyra	28
6	Licenca te transferuara/bartura	8
7	Total	162




Figura 5. Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2009

5.1.1 Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)

“Licencë për hulumtim” është autorizimi zyrtar me shkrim i lëshuar nga Komisioni në bazë të pjesës III të Rregullores 2005/3 mbi minierat dhe mineralet. Licencat për hulumtime lëshohen me afat 2 vjeçar me mundësi vazhdimi. Licencat për hulumtime për minerale ndërtimore mund të lëshohen me sipërfaqe maksimale deri në 250 hektar, ndërsa për të gjitha mineralet tjera deri në 100 km².

Në tabelën e mëposhtme kemi pasqyruar të gjitha licencat e lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2009.

Tabela 5: Licencat e lëshuara të hulumtimit gjatë vitit 2009

Nr.	Licence Nr.	NRB	Përshkrimi i komoditetit	Lloji i Licencës	Mbajtësi i Licencës	Data e lëshimit	Data e Skadimit	Komuna
1	807	70511185	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Ferromet Kosova" J.S.C.	17.04.2009	16.04.2011	Kamenicë
2	780	70476863	K-3 - rërë dhe zhavorr	hulumtim	"Silca Group" sh.a.	15.01.2009	14.01.2011	Ferizaj
3	788	70523477	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"GL - CHROMIUM " SH.P.K.	05.03.2009	04.03.2011	Gjakovë
4	789	70452108	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"NSA resources" sh.p.k.	09.03.2009	08.03.2011	Gjakovë
5	790	70452108	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"NSA resources" sh.p.k.	09.03.2009	08.03.2011	Gjilan/Viti
6	781	70452108	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"NSA resources" sh.p.k.	15.01.2009	14.01.2011	Gjilan/Viti
7	823	70486029	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Stone International" sh.p.k.	25.05.2009	24.05.2011	Mitrovicë/Leposaviq/Podujevë
8	795	70129440	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Guri Company" Sh.p.k	09.03.2009	08.03.2011	Viti
9	799	70489279	K-3 - rërë dhe zhavorr	hulumtim	N.P.P. "Kuarci" sh.p.k.	15.04.2009	14.04.2011	Lipjan
10	787	80011288	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	N.T.P. "Pro - Ars"	05.03.2009	04.03.2011	Novobërdë
11	836	70487330	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Kosovo Mining Research" sh.p.k	15.06.2009	14.06.2011	Leposaviq
12	791	70533979	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Jetoni" sh.p.k.	09.03.2009	08.03.2011	Rahovec
13	814	70532492	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Llapi Company" sh.p.k.	13.05.2009	12.05.2011	Prishtinë
14	792	70520613	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Pashtriku" sh.p.k.	09.03.2009	08.03.2011	Prizren
15	815	70404950	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Bentokosi - Ri" Sh.p.k	10.06.2009	09.06.2011	Viti
16	793	70544555	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Fani" sh.p.k.	09.03.2009	08.03.2011	Kaçanik
17	800	70530791	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Qendrimi- SP" sh.p.k.	15.04.2009	14.04.2011	Gjakovë
18	821	70427696	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Agimi" sh.p.k.	13.05.2009	12.05.2011	Deçan
19	796	70253040	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"MA.CON"Sh.p.k.	09.03.2009	08.03.2011	Istog
20	844	70362035	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	N.N.T. " Durimi " Sh.p.k.	14.07.2009	13.07.2011	Fushë Kosovë
21	838	70548860	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Festimi Company"sh.p.k.	16.06.2009	15.06.2011	Fushë Kosovë
22	819	70078442	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	N.Sh.P. "Geomatje"sh.p.k	03.07.2009	02.07.2011	Kaçanik
23	859	70385718	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Monimix"Sh.p.k.	25.08.2009	24.08.2011	Prizren
24	801	70027291	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Jaha Company"sh.p.k.	15.04.2009	14.04.2011	Vushtrri
25	855	80232241	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Nëntë Vëllezërit" sh.p.k	10.08.2009	09.08.2011	Prishtinë
26	834	70355075	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Afrimi Company"sh.p.k.	15.06.2009	14.06.2011	Novobërdë
27	865	80035080	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	N.T.P. "R & R Maliqi"	15.10.2009	14.10.2011	Prishtinë
28	824	70330853	M-1 - minerale metalike	hulumtim	Kosovo Resource Company LLC	13.05.2009	12.05.2011	Skenderaj/ Zubinpotok

29	803	70034118	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	N.T.N."Gerguri" Sh.p.k	21.04.2009	20.04.2011	Fushë Kosovë
30	816	70555301	M-2 - minerale industriale	hulumtim	"Luboteni"sh.p.k.	25.05.2009	25.05.2011	Kaçanik
31	813	70493616	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Kosan" L.L.C	10.07.2009	29.07.2010	Kamenicë
32	861	70560208	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Albakos" Sh.p.k	02.09.2009	01.09.2011	Pejë
33	822	70268073	M-1 - minerale metalike	hulumtim	Newco Ferronikeli Complex L.L.C.	13.06.2009	12.06.2011	Shtime/Suharekë/Malishevë
34	845	70122761	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Kalaja"sh.p.k.	14.07.2009	13.07.2011	Skenderaj
35	839	70233118	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Bajraktari" sh.p.k.	26.06.2009	25.06.2011	Mitrovicë
36	848	70443020	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Toni " SH.P.K.	14.07.2009	13.07.2011	Obiliq
37	820	70080965	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	N.T.Sh. "Dino" Sh.p.k	13.05.2009	12.05.2011	Lipjan
38	841	70125187	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Ylli" Sh.p.k	14.07.2009	13.07.2011	Gllgovc
39	837	70452969	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Euro Petrol" Sh.p.k	16.06.2009	15.06.2011	Malishevë
40	849	70558858	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Via Group" sh.p.k.	14.10.2009	13.10.2011	Lipjan
41	854	70576155	M-2 - minerale industriale	hulumtim	"Bentoniti" Sh.p.k	10.08.2009	09.08.2011	Kaçanik
42	842	70545152	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	"Sena" Sh.p.k	14.07.2009	13.07.2011	Klinë
43	852	70036618	K-2 - shkëmbi të fortë	hulumtim	N.P.T.T." Bajgora Trans" Sh.p.k	20.07.2009	19.07.2011	Vushtrri
44	808	70412037	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Iliria Mining Corp" Sh.p.k.	12.05.2009	11.05.2011	Leposaviq
45	846	70412037	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Iliria Mining Corp" Sh.p.k.	20.07.2009	19.07.2011	Prishtinë
46	809	70412037	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Iliria Mining Corp" Sh.p.k.	17.04.2009	16.04.2011	Leposaviq
47	779	70417976	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Minna Kompania" Sh .p.k	15.01.2009	14.01.2011	Lipjan
48	810	70465874	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Lori"Sh.p.k	17.04.2009	16.04.2011	Gjakovë
49	805	70487330	M-1 - minerale metalike	hulumtim	Kosovo Mining Research Sh.p.k	17.04.2009	16.04.2011	Leposaviq
50	778	70487330	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Kosovo Mining Research" sh.p.k	15.01.2009	14.01.2011	Gjilan/ Kaçanik/Viti
51	806	70487330	M-1 - minerale metalike	hulumtim	Kosovo Mining Research Sh.p.k	17.04.2009	16.04.2011	Mitrovicë/Leposaviq/Zveçan
52	811	70330853	M-1 - minerale metalike	hulumtim	Kosovo Resource Company LLC	15.04.2009	14.04.2011	Podujevë
53	794	70498324	M-1 - minerale metalike	hulumtim	"Karakushi" sh.p.k.	09.03.2009	08.03.2011	Gjakovë




Figura 6. Harta e licencave të hulumtimit

5.1.2 Licencat e shfrytëzimit

Me “Licencë për shfrytëzim” nënkupton licenca e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në bazë të pjesës V të Rregullores 2005/3, ndërsa “veprimtaritë xehetare” janë të gjitha veprimtaritë e ndërmarra me qëllim të kryerjes së punëve xehetare ose shfrytëzimit të ndonjë xeheje. Licencat për shfrytëzim për mineralet ndërtimore mund të lëshohen me një afat deri në 25 vite me mundësi vazhdimi, ndërsa për mineralet tjera deri në 40 vite pa mundësi vazhdimi.

Në tabelën e mëposhtme kemi pasqyruar të gjitha licencat për shfrytëzim të lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2009.

Tabela 6: Licencat e shfrytëzimit të lëshuara në vitin 2009

Nr.	Licence Nr.	NRB	Përshkrimi i komoditetit	Lloji i Licencës	Mbajtësi i Licencës	Data lëshimit	Data Skadimit	Komuna
1	847	70367060	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	N.P.P. "Bajramaliu" Sh.p.k.	20.07.2009	19.07.2017	Kaçanik
2	812	70437105	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	N.N.T. "Er-Mali" Sh.P.K.	17.04.2009	16.04.2024	Suharekë
3	832	70418843	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	N.T.P. "VD-COM" sh.p.k.	14.05.2009	13.05.2022	Kaçanik
4	857	70497581	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Vita" Sh.p.k.	18.08.2009	17.08.2014	Kaçanik
5	826	70478134	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Merkuri Company"sh.p.k	14.05.2009	13.05.2014	Skenderaj
6	784	70474249	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Ruga ING" Sh.p.k	16.01.2009	15.01.2017	Glllogovc
7	827	70268934	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	N.P.P. " 7 Shtatori "	14.05.2009	13.05.2019	Kaçanik
8	858	80397739	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Kopshti" SH.P.K	21.08.2009	20.08.2014	Vushtrri
9	828	70015951	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"New Lepenci" sh.p.k.	14.05.2009	13.05.2034	Kaçanik
10	830	70419194	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Geo Mineral"sh.p.k.	14.07.2009	13.07.2021	Fushë Kosovë
11	835	70525569	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Rea" sh.p.k.	29.06.2009	28.06.2020	Klinë
12	862	70362915	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Shkëmbi " Sh.p.k	11.09.2009	10.09.2019	Istog
13	831	70510499	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Etniku" sh.p.k	11.06.2009	10.06.2017	Klinë
14	851	80035080	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	N.T.P. "R & R Maliqi"	28.07.2009	27.07.2016	Prishtinë
15	853	70383438	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Lika-Trade" Sh.p.k	24.11.2009	23.11.2024	Deçan
16	868	70253040	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"MA.CON"Sh.p.k.	18.12.2009	17.12.2017	Istog
17	856	80020023	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	Famis CO H.C.	17.08.2009	16.08.2019	Suharekë
18	867	70524570	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Joos-Krasniqi Limited Construcion" sh.p.k	04.11.2009	03.11.2019	Deçan
19	840	70027511	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	N.N.P. "Qendrimi" Sh.p.k	13.07.2009	12.07.2015	Lipjan
20	860	70581302	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Arena Invest" sh.p.k.	26.08.2009	25.08.2014	Leposaviq

21	785	70268073	M-1 -minerale metalike	shfrytëzim	Newco Ferronikeli Complex L.L.C.	20.01.2009	19.01.2019	Gllgovc
22	864	70370465	M-2 - minerale industriale	shfrytëzim	"Osberg Limited" D.O.O.	06.10.2009	05.10.2014	Leposaviq
23	797	70365436	K-3 - Rërë dhe zhavorr	shfrytëzim	"Transportuesi" Sh.p.k.	10.03.2009	09.03.2012	Pejë
24	825	70350236	M-2 - minerale industriale	shfrytëzim	Miniera dhe Industria e Magnezitit "Golesh"	14.05.2009	13.05.2012	Lipjan
25	863	70370465	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	"Osberg Limited" D.O.O.	06.10.2009	05.10.2014	Leposaviq
26	798	70412697	K-2 - shkëmbi të fortë	shfrytëzim	Gurëthyesi " Celi Ag" Sh.p.k.	31.03.2009	30.03.2022	Suharekë
27	865	80035080	K-2 - shkëmbi të fortë	Shfrytëzim	N.T.P. "R & R Maliqi"	15.10.2009	14.10.2011	Prishtinë




Figura 7. Harta e licencave të shfrytëzimit

5.1.3 Lejet për punë të posaçme

Në grupin e lejeve për “Punë të posaçme” përfshihen :

(a) Punët kërkimore ku përfshihen;

- Shpimet,
- Hapja e kanaleve,
- Marrja e mostrave, duke përfshirë edhe mostrat e papërpunuara,
- Vrojtimit gjeofizike, ku përfshihen matjet me anë të aeroplanëve ose metodave elektrike me tension të lartë,
- Funksionimi i makinerisë ose pajimeve dhe
- Çdo veprimtari e ndërlidhur e kryer për qëllime të kërkimit të cilat e ndryshojnë apo e çrregullojnë fizikisht sipërfaqen e tokës.

(b) Përdorimi dhe shkatërrimi i mjeteve plasëse për nevojat e sektorit mineral,

(c) Fillimi i punëve xehetare ose xehetaria zejtare,

(d) Punë në xehetari ku përfshihen:

- (i) Përdorimi ose funksionimi i makinerisë apo i pajimeve ose
- Veprimtaritë tjera që mund të caktohen nga komisioni

(e) Trajtimi, ruajtja ose përpunimi i mineraleve ku përfshihen:

- Përdorimi ose funksionimi i makinerisë apo pajimeve,
- Përdorimi i kemikateve ose reagjentëve të tjerë ose
- Veprimtaritë tjera që mund të caktohen nga Komisioni.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar detajet e lejeve për punë të posaçme të lëshuara nga KPMM për vitin 2009.

Tabela 7: Lista e lejeve të veçanta të lëshuara gjatë vitit 2009

Nr.	Nr. i Lejes	NRB	Emri i kompanisë	Komuna	Lloji i objektit	Data e lëshimit	Data e skadimit
1	313	70380534	"Egzoni" Sh.p.k.	Prizren	bazë betoni	18.09.2009	17.09.2012
2	333	80035985	Burimi SH.P.K	Ferizaj	bazë asfalti	21.04.2009	20.04.2012
3	334	80035985	Burimi SH.P.K	Kaçanik	seperacion	21.04.2009	20.04.2012
4	336	70136472	N.P.Sh "Shpejtimi" sh.p.k	Shtime	seperacion	24.03.2009	23.03.2012
5	347	70404950	"Bentokosi - Ri" Sh.p.k	Viti	seperacion	09.07.2009	08.07.2011

6	353	80079206	„Granit" Sh.p.k.	Istog	bazë asfalti	21.04.2009	20.04.2012
7	354	80079206	„Granit" Sh.p.k.	Istog	bazë betoni	21.04.2009	20.04.2012
8	356	80580380	N.T.P. "Orana"	Ferizaj	seperacion	28.08.2009	27.02.2010
9	363	70423360	"Daci " Sh.p.k.	Pejë	seperacion	14.01.2009	13.01.2012
10	364	70323510	"Trasing Group " Sh.p.k.	Gllgovc	seperacion	14.01.2009	13.01.2012
11	366	70035478	"Benita Company"Sh.p.k.	Mitrovicë	seperacion	21.04.2009	20.04.2012
12	372	70385373	Mineral L.L.C	Gllgovc	seperacion	17.06.2009	16.06.2012
13	373	70467020	"EUROFAMIS"SH.A.	Malishevë	seperacion	26.08.2009	25.08.2012
14	374	70392481	"Merkur Metallhandels Gmbh" SH.P.K.	Gllgovc	seperacion	05.10.2009	04.10.2012
15	375	70035387	N.P.P.,,Niti" Sh.p.k.	Lipjan	seperacion	28.08.2009	27.02.2010
16	377	70430096	"GHM Company" Sh.p.k	Prishtinë	Punë të posaçme	22.06.2009	21.06.2012
17	378	70369981	"Dakaj - H" Sh.p.k	Pejë	seperacion	26.08.2009	25.08.2012
18	379	70367993	"Mermer Commerce 1" Sh.p.k.	Shtime	seperacion	27.08.2009	26.08.2012
19	382	70412697	Gurëthyesi " Celi Ag" Sh.p.k.	Suharekë	seperacion	27.08.2009	26.08.2012
20	384	80014112	N.T.P.,,DoniFERT"	Gllgovc	seperacion	02.10.2009	01.10.2012




Figura 8 Harta e licencave për punë të posaçme

Me poshtë kemi paraqitur ne mënyrë tabelore numrin e te gjitha licencave te lëshuara nga viti 2005 deri ne vitin 2009 si dhe kemi bere krahasimin ne formë grafike.

Tabela 8: Licencat/lejeve e lëshuara nga KPMM sipas viteve dhe llojit të licencave/lejeve

Lloji i licencës/lejes	2005	2006	2007	2008	2009	Gjithsejtë
Licenca të hulumtimit	10	13	27	74	53	177
Licenca të shfrytëzimit	33	49	54	38	26	200
Leje të posaçme	10	15	37	33	20	115
Gjithsejtë	53	77	118	145	99	492




Figura 9 Licencat/lejeve e lëshuara sipas viteve

6. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË INSPEKTORATIT

Puna dhe aktiviteti në veprimtaritë minerare është punë me shumë përgjegjësi, punë e rrezikshme, por edhe punë që kërkon zbatueshmëri të rreptë të të gjitha rregullave dhe ligjeve, të cilat e mbulojnë këtë fushë.

Departamenti i Inspektoratit që funksionon pranë KPMM-së, ka inspektorë të të gjitha lëmive përkatëse.

Në Kosovë puna në xehetari ka pasur dhe ka një traditë të lashtë, prandaj përveç arritjes së rezultateve të prodhimit ekziston edhe niveli i sigurisë në punë, që ka qenë në nivel të kënaqshëm. Kjo përvojë e mirë duhet të bartet edhe tek sektori privat, sepse në rend të parë është siguria dhe mbrojtja në punë, dhe kushtet e kënaqshme për punë pa dyshim se do të çojnë edhe në rezultatet e duhura të prodhimit.

Tani me krijimin e sektorit privat në mihjet sipërfaqësore ka një aktivitet shumë të shtuar, për çka edhe tek Departamenti i Inspektoratit kërkohet punë shumë aktive dhe efikase, në mënyrë që mos të lejohen të shkelen rregullat dhe normat teknike sa i përket mbrojtjes dhe sigurisë në punë.

Detyrat kryesore të inspektoratit janë:

- vlerësimi i projekteve xehetare të kompanive që kanë aplikuar për licencim,
- kontrolli i projekteve dhe krahasimi i tyre në terren,
- përgatitja e raporteve për licencim të kompanive për bord,
- inspektimi i kompanive pas licencimit,
- kontrolli i sigurisë dhe mbrojtjes në punë në miniera,
- kontrolli i implementimit të projekteve në bazë të cilave kompania është licencuar,
- inspektimet e rregullta xehetare që parashihen sipas ligjit,
- përcjellja e eksplozivëve gjatë importit, deponimit, përdorimit, përgatitja e lejeve për minim dhe certifikimi i minandezësve etj.

Dihet se në Minierat në Kosovë një kohë të gjatë është punuar në kushte shumë të kufizuara, kjo dukuri, ka shkaktuar ndërprerje të vazhdimit të kontinuitetit të ushtrimit të veprimtarive profesionale. Puna në Miniera kryhet në kushte shumë të rënda dhe specifike. Kërkohet, angazhim i madh dhe profesionalizëm i lartë.

Gjatë inspektimeve të rregullta janë vërejtur se në vendet e punës me përgjegjësi të lartë punojnë punëtorët pa kualifikime adekuate, këto dukuri rreptësisht i ndalon Ligji i Minierave dhe Rregullorja për mbrojtje teknike në punë.

Prandaj ne si Organ përgjegjës dhe profesional, kemi kërkuar nga kompanitë respektivisht – Menaxherët e minierave, të organizojnë, trajnimin për përgatitjen profesionale të minatorëve, në mënyrë që ata të aftësohen për kryerjen e punëve dhe detyrave me përgjegjësi. Andaj në këtë drejtim është bërë një punë shumë e suksesshme për aftësimin e minatorëve dhe pastaj certifikimin e tyre sipas punëve dhe detyrave që parashihen.

Tabela 9: Lista e punëtorëve të certifikuar sipas minierave

Miniera	Min a ndez ës	Xeh. i KU	Xeh i.KL	Makin ist i makin ës ngritës e	Sinjalist		Kompr esorit	Pom - pista	Manip ulues të makin ave ngarku ese	Vozitës të Lokomo tivave në minierë i	Manipulue s i makinave për shpurje të Thella
					Sinjali st i Liftit për bartjen e punëto rve	Sinjali st për mbush jen e Skipav e					
Artanës	7	4	4	-	-	-	-	-	-	4	
S. Tërg	-	-	-						11		4
Crnac	23		-				4		15.	24.	
B.Bërdo	15		3				6		8.	11.	
Gjithsej	45	4	7				10		34	39	4

6.1 Lëndimet e shkaktuara gjatë vitit 2009

Në vitin 2009 gjatë punës në veprimtarin minerare, janë shkaktuar lëndime të natyrës së lehtë, të rëndë dhe vdekjeprurëse. Inspektorati për të gjitha rastet e paraqitura ka dalë në vend të ngjarjes, si dhe janë hartuar raportet.

Tabela 10: Lista lëndimeve gjatë vitit 2009

Nr.ren.	Vendi ku ka ndodh lëndimi	Lëndime të lehta	Lëndime të rënda	Lëndime vdekjeprurëse	Gjithsej
1.	Miniera “Crnac”	8			8
2	Miniera e “Artanës”		5		5
3	Miniera Kizhnica Auto transporti			1	1
3	Miniera e S. Tërgut	66	4		70
4	NewCo Feronikeli Kompleks L.L.C	74	5		79
5	Miniera e Kromit Deva - Gjakovë		1		1
6.	“ KEK”	100		1	101
	Gjithsej	248	15	2	265

Shkaqet me te shpeshta te konstatuara nga Inspektorati i Minierave lidhur me aksidentet dhe avarit e ndodhura janë:

- Përdorimi jo-adekuat dhe i pamjaftueshëm i pajisjeve personale të mbrojtjes në punë;
- Gjendja teknike e pajisjeve dhe stabilimenteve jo e kënaqshme në kompanitë e mëdha (si KEK-u, Trepça,etj);
- Pakujdesia dhe neglizhenca e punëtorëve si dhe,
- Trajnimet dhe aftësimi jo i mjaftueshëm i punëtorëve e veçanërisht nga lëmi i sigurisë dhe mbrojtjes në punë

6.2 Aktivitetet e sektorit të eksplozivëve

6.2.1 Aktivitetet e minimeve-Përdorimi i eksploziveve

Gjatë vitit - 2009 janë realizuar 22 importime të eksplozivit, nga këto kompani: “Tropikana & Minervo”, “Bariu”, “Ex-Projekt”, “Niti”, dhe “Jaha Company” me sasi si me poshtë:

- Eksploziv Amonit 509578 kg
- Eksploziv Anfo 167725 kg
- Fitol Detonues479000 m
- Ngadalësues milisekondar 5500 copë
- Detonator elektrik 155000 copë
- Nonel (LP, MS, Bcord) 80530 copë
- Nonel Dynoline 257114 m

Përveç sasive te importuara kompanitë e mëposhtme kanë prodhuar eksploziv te tipit ANFO brenda ne Kosovës si me poshtë:

- “Jaha Company”..... 522944 kg
- “Tropicana & Minervo”..... 216130 kg
- Gjithsejtë.....739074 kg

Lejet e minimeve

Duke u bazuar ne Ligjin për themelimin e KPMM-se dhe rregulloren për miniera dhe minerale, KPMM ne kuadër te përgjegjësiive te saja gjatë vitit 2009 ka lëshuar 284 leje për minime, te specifikuara si me poshtë:

- Lejet e lëshuara për minierat sipërfaqësore.....227
- Lejet e lëshuara për minierat nëntokësore..... 57

Gjatë këtij viti Inspektorati ka kryer një varg inspektimesh në kompanitë minuese dhe në minierat me shfrytëzim sipërfaqësor dhe nëntokësor në tërë Kosovën, duke përfshirë inspektimet e para minimeve e deri të inspektimet e bëra në mënyrë të drejtpërdrejt gjatë operacioneve minuese.

Të gjitha aktivitetet me eksplozive dhe materiale inicuese gjatë vitit 2009 u përfunduan sipas standardeve të sigurisë dhe me sukses të plotë pa asnjë incident me pasoja në njerëz dhe dëme materiale.

Në kuadër të lejeve për minime gjatë vitit 2009 janë lëshuar edhe leje për minime speciale. Minimet speciale janë ato minime që përdoren jashtë licencës së lëshuar nga KPMM, e që mund të jenë për hapjen e ndonjë rruge, përgatitjen e terrenit për ndërtimin e ndonjë objekti, etj.

Në minierat sipërfaqësore për prodhimin e materialeve ndërtimore, gjatë vitit 2009 janë kryer gjithsej 123 minime dhe 7 minime speciale. Sasia e eksplozivit dhe materieve inicuese të shpenzuar për vitin 2009 ka qenë:

- Explosive Amonit 338207 kg
- Eksploziv Anfo 872549 kg
- Fitol Detonues..... 408440 m
- Nonel (SL, Unidet)19364 copë
- Ngadalësues milisekondar4318 copë
- Nonel Dynaline 53950 m

Eksplozivi i hargjuar në minierat nëntokësore -" Trepçës":

Në minierat me shfrytëzim nëntokësor janë realizuar 57 zhvendosje të eksplozivit, në depot doracake në horizontet e minierave nëntokësore, nga të cilat është harxhuar kjo sasi e eksplozivit dhe materieve inicuese:

- Eksploziv Amonit 111747 kg
- Nonel (MS, LP) 94780 copë
- Vegëza (Buch Cord) 5800 copë
- Nonel Dynoline 449428 m
- Detonator Elektrik 93500 copë

Miniera e "Trepçës " në Artanë:

- Eksplozivë Amonit 3840 kg
- Nonel (MS, LP) 8300 copë
- Vegëza (Buch Cord)..... 1200 copë
- Nonel Dynoline 78000 m

Miniera e "Trepçës " në Stantërg:

- Explosive Amonit 41729.8 kg
- Nonel (MS, LP) 68200 copë
- Vegëza (Buch Cord)..... 400 copë
- Nonel Dynoline 318929 m

Miniera e “Trepçës “ në Cernac:

- Explosive Amonit 59928 kg
- Nonel (MS, LP) 15680 copë
- Vegëza (Buch Cord)..... 800 copë
- Nonel Dynoline 43500 m
- Detonator Elektrik 84000 copë

Miniera e “Trepçës “ në Belobërdo:

- Explosive Amonit 6290 kg
- Nonel (MS, LP) 2600 copë
- Nonel Dynoline 9000 m
- Detonator Elektrik 9500 copë

Masa e materialit shkëmbor e fituar nga minierat sipërfaqësore

Në bazë të dhënave gjeometrike të marruar nga personat përgjegjës të kompanive dhe inspektimeve të bëra nga inspektorët e regjioneve para çdo minimi është llogaritur se sasia e përafërt e materialit të fituar nga 123 operacione minimi arrin sasinë prej 2,474,059.72 m³. Gjithashtu nuk janë llogaritur sasi të materialit nga 7 operacione minimi që është përdorur për hapje të rrugëve të ndryshme lokale.

Aktivitetet ilegale

Një ndër detyrat e KPMM-se gjatë vitit 2009 ka qenë edhe ndalimi i operuesve ilegale në sektorin minerar, kryesisht në aktivitet të shfrytëzimit të mineraleve ndërtimore dhe industriale, përgjatë brigjeve të lumenjve dhe në afërsi të rrugëve. Edhe përkundër angazhimit të madhe të stafit të KPMM-se në ndalim të operimeve ilegale nëpërmes lëshimit të urdhërësive për ndalim të punës, gjobitjes dhe përcjelljes së rasteve në prokurori, megjithatë nuk është arritur sukses në ndërprerjen e tyre.

Shfrytëzimet ilegale kanë efekte të shumta negative, duke filluar nga dëmtimi i ambientit, ikja nga tatime, konkurrenca jolojale ndaj kompanive të licencuara, si dhe ofrimi i një kualiteti të dobët për rrugët të cilat janë financuar nga Institucionet qendrore dhe lokale. Me poshtë kemi paraqitur tabelën e shfrytëzuesve ilegale në tere territorin e Republikës së Kosovës të cilat është arritur të identifikohen gjatë vitit 2009, ndërsa në pjesën e fundit të raportit kemi paraqitur propozimin se si mund të arrihet që të ndalohet operimi i tyre.

Regjistri i Seperacioneve që operojnë pa Licencë të KPMM-se

Tabela 11: Lista e seperacioneve ilegale

1	"Ardi"	70034099	Shipashnic poshtme e	Kamenicë	Rërë dhe Zhavorre	seperacion
2	"Imrani"	70086231	Muçivrcë	Kamenicë	Rërë dhe Zhavorre	seperacion
3	"Besi"		Muçivrcë	Kamenicë	Rërë dhe Zhavorre	seperacion
4	"Area"	70052875	Hodonovc	Kamenicë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
5	"Agi Dani"	70054992	Dheu I Bardhë	Kamenicë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
6	"Ardhmëria"	80069367	Topanicë	Kamenicë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
7	"V.Borovci"	70096573	Berivojc	Kamenicë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
8	"V.Borovci"	70096573	Kodra e Topanices dhe Kormian	Kamenicë	Argjila	seperacion
9	"Krileva Company"	80033982	Hajnovc	Kamenicë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
10	Imining Mgo Grup XIM Strezovc	80304706	Strezovc	Kamenicë	Dolomitë	seperacion
11	"Kamerolli"	80038534	Malishev e epërme	Gjilan	Gëlqerorë	seperacion
12	"Hajrizi Company"	80148003	Mireshe	Gjilan	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
13	"Sllubica"sh.p.k		Sllubicë	Gjilan	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
14	"Guri' sh.p.k	70454210	Koretishtë	Gjilan	Gëlqerorë	seperacion
15	"Kofix"	70436663	Koretishtë	Gjilan	Gëlqerorë	seperacion
16	"10 Vëllezërit"		Ugëlar	Gjilan	Gëlqerorë	seperacion
17	"Irfacom"	80454295	Surçinë	Ferizaj		seperacion
18	"New Silkapor"	80496834	Mirosal	Ferizaj	Rërët e kuarcit	seperacion
19	"Dafa"		Mirosal	Ferizaj	Rërët e kuarcit	seperacion
20	"Veli Commerce"		E. e Jezercit	Ferizaj		seperacion
21	"Ana"	80584988	Gotovushë	Shterpc	Gëlqerorë	seperacion
22	Rudi("Visioni 2002")	80079672	Bainc-Cares	Shterpc	Gëlqerorë	seperacion
23	"BashMarti"	80254334	Gjakovë	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
24	Vllezerit Berisha"		Gerqin	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion

25	"Berdibes"		Rugovë	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
26	"Rogovë I"		Dublibar	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
27	"Saudi-Sh"		Radonicë (Strellcë)	Deqanë	Gëlqerorë	seperacion
28	"Liridoni-M"		Zahaqë	Pejë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
29	"VII Fetaj"		Kralan	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
30	"Morina"		F.Silovene	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
31	"Koni"		Zidi sadik	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
32	"Bala"		Mulliqë	Gjakovë	Gëlqerorë	seperacion
33	'Sali -LDE'		Rudeshë	Istogë	Gëlqerorë	seperacion
34	"Podrimja 1'			Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
35	"Podrimja"			Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
36	"Te Aleni"		Vrell	Istogë	Gëlqeror	seperacion
37	"Guri' N.P		Vrell	Istog	Gëlqeror	seperacion
38	"Erozioni"		Brestovikë	Pejë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
39	"Grinta'		Jabllanice e madhe	Pejë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
40	"5 VILLEZERIT KAQORRAJ"		Isniq	Deqanë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
41	"Ermali"		Shishman	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
42	Shkambi'		Synaj	Istog	Gëlqerorë	seperacion
43	"Vllezerit Kryeziu"		Rogove e Hasit	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
44	"Ndertimi"		Gllaviqicë	Pejë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
45	"Eurodrini"		Rogove e Hasit	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
46	N.P."VICTORIA INVEST INTERNATIONAL" Sh.p.k	70038606	Volljakë	Klinë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
47	"KE-Luani 1"		Fusha e Tahir Beut	Pejë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
48	"Luli Trans"		Koronicë	Gjakovë	Rërë dhe Zhavorr	seperacion
49	Dervishi		Krushë e madhe	Rahovec	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
50	"Krusha"		Krushë e madhe	Rahovec	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
51	"Drini Holding"		Krushë e vogël	Rahovec	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
52	"Hajdari"sh.p.k		Krushë e vogël	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim

53	"Gania"		Xërxë	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
54	"Burimi"		Arbanë	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
55	"Graniti"		Landovic	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
56	"Kalimashi"		Landovic	Rahovec	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
57	"Landovica"		Arbanë	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
58	"Fitmi Comerc"		Zhurë	Prizren	Gëlqeror	Seperim
59	"Dili Comerc"		Landovic	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
60	"1 Maji"		Xerxe	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
61	"Timi Comerc"		Grejkovc	Prizren	Gëlqeror	Seperim
62	Person Privat		Krush e madhe	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
63	"Sopi"		Kuqisht Krushev	Dragash	Gëlqeror	Seperim
64	"Tregtia"		Dobidoll	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
65	"SoniCom"		Krushë e vogël	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
66	N.P.ZH"Liridon"	80070058	Dobidol	Rahovec	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
67	"Sejfullahu"sh.p.k.	70392572	Ratkoc	Rahovec	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
68	"Condor"		Kramovik	Rahovec	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
69	"Destani"	70128812	Peçan	Suharek	Gëlqerorë	Seperim
70	"Dardani AG"	70156170	Studençan	Suharek	Gëlqerorë	Seperim
71	"I Seferi"	70373100	Biraç	Suharek	Gëlqerorë	Seperim
72	"Zatriqi"	80148496	Astrazup	Malishevë	Gëlqerorë	Seperim
73	"Vllëzrit Bashkuar"sh.p.k	70155872	Vermicë	Prizren	Gëlqerorë	Seperim
74	"Doni"		Landovicë	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
75	"Vellezërit Bashku"	70230339	Mushtishtë	Suharek	Gëlqerorë	Seperim
76	"Flori Kopshtar"	70436386	Studençan	Suharek	Gëlqerorë	Seperim
77	"ETEM TRADE"	70429297	Zhurë	Prizren	Gëlqerorë	Seperim
78	"SHARRI BETON"	70196590	Zidina 16 Hogë	Prizren	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
79	"Vorld beton Compani"		Maxhunaj	Vushtrri	Rërë dhe Zhavorr	Seperim
80	"R&Rukolli"Sh.p.k	70222353	Pasomë	Vushtrri	Gëlqerorë	Seperim
81	"Edona"sh.p.k	70426374	Mirash	Ferizaj	Gëlqerorë	Seperim
82	"GURMALI"Sh.p.k	70423868	Akllap	Janjevë	Gëlqerorë	Seperim
83	"Sokoli Company"	70529971	Magurë	Lipjan	Dunite dhe Serpentinite	Seperim

Tabela 12: Kompanitë ilegale të shfrytëzimit të gurëve gëlqerorë, rërës dhe zhavorrit gjatë vitit 2009

Nr. I Regj.	Emri I kompanise	Lokacioni	NRB	Përshkrimi i Vendit	Veprimtaria
10000	"Fani" sh.p.k.	Bobë	70544555	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10001	"Morina"	Bishtazhin		K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10002	Seperacioni "Makolli" N.T.P	Bishtazhin		K-3 - sand and gravel	Ilegal
10003	Victoria Invest International	Volljakë	70038606	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10004	Noti Sh.p.k	Kegekoll		K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10005	Fizik	Zhiti		K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10006	Shatmani			K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10007	Shkëmbi	Sukë		K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10008	"Sokoli Company" sh.p.k.	Vrellë	70529971	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10009	"Lika-Trade" Sh.p.k	Lubeniç	70383438	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10010	"World Beton Company" Sh.p.k	Maxhunaj	70238765	K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10011	"Agimi" Sh.p.k.		70367769	K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10012	Dili Comerc		80460813	K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10013	Sami Duraku			K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10014	Krusha		80029888	K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10015	Person fizik "Shaqir Emini"			K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10016	"Aferdita"	Laçiq		K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10017	"Xhelal Trans"	Laçiq		K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10018	N.T.P. " Kastrioti "	Llazicë	80004001	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10019	"Guri" Sh.p.k	Lebane	70590360	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10020	"Riviera - Toni"	Vranidoll		K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10021	Beni Com	Vranidoll		K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10022	"Eurotrans"	Partesh		K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10023	"KE Luani - 1" Sh.p.k	Fusha e Tahir Beut		K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10024	"Ibri" Sh.p.k	Zhabarë		K-3 - rere dhe zhavorr	Ilegal
10025	"Nëntë Vëllezërit" sh.p.k	Radashevc	80232241	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10026	N.P.T.SH."Getoari"Sh.p.k.	Topille	70130201	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10027	"Ylli" Sh.p.k	Llapushnik	70125187	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10028	"Enver Vrajolli"	Badovc		K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10029	"Vëllezërit Vrajolli" sh.p.k.	Badovc	70375361	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10030	"Arben Rustemi"	Sankovc		K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10031	N.P.P. " 7 Shtatori "	Semajë	70268934	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal
10032	Rudi	Rrasat e Cares	80079672	K-2 -guri gëlqeror	Ilegal

10033	"Linda Com" SH.P.K	Llapushnik	70600161	K-2 -guri gelqeror	Illegal
10034	"Albakos" Sh.p.k	Bello Poje - Bjeshka e Irzniqit	70560208	K-2 -guri gelqeror	Illegal
10035	Mefail A. Helshani	Grab, Ngucat		K-2 -guri gelqeror	Illegal
10036	Victoria Invest International	Volljakë	70038606	K-3 - rere dhe zhavorr	Illegal
10037	"Feridi Company"Sh.p.k.	Llojza	70041814	K-2 -guri gelqeror	Illegal
10038	Gëzim Rexhepi	Bajqinë		K-3 - rere dhe zhavorr	Illegal
10039	"TOIFOR"	Doberdol		K-2 -guri gelqeror	Illegal
10040	"Titanbeton" sh.p.k.	Arbëria			Illegal
10041	Dili Comerc	Krajkë	80460813	K-3 - rere dhe zhavorr	Illegal
10042	"Ermali" sh.p.k.	Shishman	80595760	K-3 - rere dhe zhavorr	Illegal
10043	"Sokoli Company" sh.p.k.	Mirenë	70529971	K-2 -guri gelqeror	Illegal
10044	NTP Toni	Sojevë			Illegal
10045	NPTSH "Dafi Company"	Sojevë	80640226		Illegal
10046	Artan Gashi	Sllovi		K-3 - rere dhe zhavorr	Illegal
10047	"EUROFAMIS"SH.A.	Sankoc	70467020	K-2 -guri gelqeror	Illegal
10048	NTP Beton Nika	Gërlisë			Illegal
10049	"XHONI"	Gadime		K-2 -guri gelqeror	Illegal
10050	Eurokos	Shalë		K-2 -guri gelqeror	Illegal

7. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË GJEOLGJISË

Departamenti i Gjeologjisë në kuadër të KPMM-së përveç tjerash ka edhe rolin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe ka realizuar disa projekte që lidhen me krijimin e informacioneve gjeologjike bazë që duhet t'i ketë një shtet, si Hartat Gjeo-shkencore, matjet gjeofizike nga ajri, matjet gjeokimike (që janë bërë vetëm për një pjesë të vogël të territorit të Kosovës), etj.

Përveç kësaj, përmes Departamentit të Gjeologjisë janë proceduar kërkesat për licenca hulumtimi dhe shfrytëzimi, si dhe është mbajtur baza e të dhënave mbi shfrytëzimin e resurseve minerale në Kosovë.

Duke u bazuar në raportimet e rregullta të kompanive minerare posedues të licencave të shfrytëzimit, si dhe verifikimeve që bëhen nga departamentet përkatëse, sektori i resurseve minerale mban shënime të rregullta mbi sasinë e shfrytëzimit të lëndëve të para minerare.

Më poshtë janë paraqitur në forme tabelore dhe grafike sasinë e shfrytëzuara sipas lëndëve të para minerale: minerale ndërtimore¹, minerale metalike² dhe linjiti³.

Tabela vijuese paraqet Rezervat e shfrytëzuara nga kompanitë gjatë TM1, TM2, TM3, TM4 2009

Tabela 13: Rezervat e shfrytëzuara nga kompanitë gjatë TM1, TM2, TM3, TM4 2009

Nr. rendor.	Lënda minerale për shfrytëzim	E planifikuar	E realizuar	Ndryshimi	Realizimi në %	Njësia matëse
1	Gëlqeror	4,956,126.79	2,164,589	4,048,978	43.68%	m3
2	Rërë dhe Zhavorr	195,339.50	46,085	149,255	23.59%	m3
3	Mergel	760,307.00	291,829.00	468,478	38.38%	m3
4	Andezite	250,000.00	58,778.08	191,222	23.51%	m3
5	Proluvion	5,670	2,620	3,050	46.21%	m3
6	Argjilë	121,800	78,812.99	42,987	64.71%	m3
7	Rëra kuarcore	61,000	20,180.90	40,819	33.08%	m3
8	Andezite-Bazalte	100,000	7,194.09	92,806	7.19%	m3
9	Harcburgiti	46,200	8,787.92	46,200	19.02%	m3

¹ Për gëlqerorë dhe andezite të dhënat janë nga raportet e minimit, kurse për të tjerat nga raportimi i kompanive

² Të dhënat janë nga raportimi i kompanive

³ Të dhënat janë nga raportimi i kompanive




Figura 10. Prodhimtaria e mineraleve ndërtimore për vitin 2009

Tabela 14: Prodhimtaria e mineraleve ndërtimore dhe industriale 2005 - 2009

Minerali	2005	2006	2007	2008	2009
Gëlqeror	629,612	777,491	879,797	1,917,196	2,164,589
Rërë dhe Zhavorr	14,894	35,650	41,621	45,463	46,085
Mergel	264,814	254,386	260,707	322,007	291,829.00
Andezite	0	19,940	36,321	45,005	58,778.08
Proluvion	4,515	3,800	2,610	3,121	2,620
Argjilë			27,614	35,382	78,812.99
Rëra kuarcore			26,800	27,325	20,180.90
Andezite-Bazalte					7,194.09
Harcburgiti					8,787.92




Figura 11. Paraqitja grafike e prodhimit të mineraleve ndërtimore 2005 - 2009




Figura 12. Prodhimi i gëlqerorëve sipas viteve 2005 – 2009




Figura 13. Planifikimi dhe realizimi i prodhimit për gëlqerorë 2005 – 2009




Figura 14. Prodhimi i rërës dhe zhavorrit sipas viteve 2005 – 2009




Figura 15. Planifikimi dhe realizimi i prodhimit për rërë dhe zhavorr 2005 - 2009

Siç vërehet nga grafikët, kemi një mospërputhje të konsiderueshme në mes të sasisë së planifikuar (projektuar) të shfrytëzimit dhe sasisë së realizuar. Arsyeja kryesore është se kompanitë e licencuara kanë një konkurrencë jolojale në treg për shkak të aktiviteteve ilegale të shfrytëzimit. Kjo ka rezultuar që kompanitë e licencuara të reduktojnë prodhimin.




Figura 16. Prodhimi i xehes së Nikelit 2007 - 2009




Figura 17. Prodhimtaria e xehes së Pb-Zn 2005 – 2009



Figura 18. Pamje nga Miniera e Linjitit ne KEK




Figura 19. Prodhimi i linjitit 2004 – 2009

7.1 Arkivi

Në kuadër të Departamentit të Gjeologjisë ekziston edhe Arkivi i KPMM-së, në të cilin hyn dhe Arkiva gjeologjike. Arkiva Gjeologjike ofron shërbime përveç KPMM-se edhe kompanive të interesuara për investime në sektorin minerare në Kosovë si dhe institucioneve tjera të cilave ju nevojiten të dhënat gjeologjike për të përgatitur planet zhvillimore lokale dhe qendrore. Vlen të përmendet se KPMM ka një arkiv të digjitalizuar dhe të gjitha procedurat e arkivimit janë të digjitalizuar.

8. PROJEKTET 2009

KPMM për të arritur misionin në sektorin e mineraleve dhe minierave ka vazhduar me zhvillimin e programeve teknike. Në vitin 2009 janë realizuar këto programe:

- Përpilimi dy plansheteve të hartës gjeologjike të Kosovës 1:25000,
- Plani i menaxhimit të resurseve minerale të Kosovës
- Sistemi i menaxhimit të informatave të bazës së të dhënave të Kosovës
- Mirëmbajtja e website
- Mbështetje KPMM-se për kryerjen e Analizave Gjeokimike.

8.1 PËRPILIMI I PLANSHETEVE TË HARTËS GJEOLGJIKE TË KOSOVËS

Rilevimi gjeologjik në shkallë 1 : 25 000 ka përfshi rajonin Volljakë – Kramovik. Rajoni i rilevuar paraqet një nyje të rëndësishme në gjeologjinë e Kosovës dhe më gjerë. Në aspektin shkencor në këtë rajon janë evidentuar fakte të terrenit me rëndësi thelbësore për trajtimet paleogjeografike dhe paleotektonike të brezit Dinarido – Albanido – Helenid.

Gjatë rilevimit gjeologjik janë sqaruar në mënyrë të kënaqshme shumica e problemeve gjeologjike të rajonit. Janë trajtuar probleme të stratigrafisë, tektonikës, magmatizmit e resurseve minerale dhe janë përpiluar hartat gjeologjike, strukture dhe të mineraleve dobishme për të dy planshetet e përfshira në studim.

KPMM planifikon që të vazhdojë me projektin e rilevimit të tërë territorit të Kosovës në shkallë 1: 25 000.

8.2 Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës (PMRMK)

Qëllimi kryesor i Planit të Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës është që të caktohen objektivat për shfrytëzim të përgjithshëm të koordinuar dhe të qëndrueshëm të resurseve minerale në Kosovë. Kjo merr parasysh veçoritë specifike dhe kushtet e zonave të veçanta, shfaqjet specifike të resurseve minerale të veçanta e kërkesat për shfrytëzimin e tyre dhe përdorimin komercial dhe industrial.

Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës është plotësuar me harta të detajuara me shkallë 1: 50,000 që mbulon Kosovën në 45 plansheta, një përmbledhje e hartës me shkallë 1: 200,000 që mbulon tërë Kosovën, një përshkrim i zonave të mbrojtura minerare dhe pasaportave për zonat e interesit.




Figura 22. Hartë vështruese e zonave të mbrojtura minerare të mineraleve ndërtimore




Figura 23. Hartë vështruese e Zonave të mbrojtura minerare të mineraleve metalike dhe industriale




Figura 24. Hartë vështruese e zonave të mbrojtura minerare të hidrokarbureve të ngurta (linjiteve)




Figura 25. Hartë vështruese e zonave të interesit

8.3 Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të Informatave (Gjeodatabaza e Kosovës) dhe Mirëmbajtja e Ueb faqes

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) ka Sistemin e Menaxhimit Informativ (SMI)- Gjeodatabazën e Kosovës (GDK). SMI mbështet disa procese të punës së KPM-së, duke përfshirë menaxhimin dhe lëshimin e Licencave për Hulumtim dhe Shfrytëzim si dhe Lejeve për Punë të Posaçme. Veç këtyre, përmes kësaj baze të dhënave menaxhohet çdo e dhënë e KPM-se e ruajtur në mënyrë elektronike (siç janë dokumentet dhe raportet, hartat gjeoshkencore, të dhënat e vendburimeve minerale, arkivën dhe të tjera).

SMI-GDK përbëhet nga module të ndryshme që bashkëveprojnë me njëra tjetrën. Komponentët kryesor të sistemit janë: databaza Microsoft SQL Server 2000 me modulën ArcSDE v8.3 për menaxhimin e të dhënave hapësinore, GUI që përbëhet nga VB. Rrjet gjithëpërfshirës, dhe ESRI ArcMap v8.3 të zakonshëm dhe aplikacionin e objekteve të hartës ESRI. Sektori i mineraleve luan një rol kyç në rindërtimin e ekonomisë së Kosovës dhe perspektivat e ardhshme të vendit dhe një SMI që funksionon mirë dhe e re, i cili u jep investitorëve, qasje direkt në të dhënat e sektorit minerar është një parakusht për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Ueb faqja e KPM <http://www.kosovo-mining.org> është një ueb faqe ndërvepruese e zhvilluar që shfrytëzon gjuhë të ndryshme programuese duke përfshirë Java-JSP, XML, dhe kodin standard HTML. Ueb faqja është e ndërlidhur me databazën SQL, ArcSDE dhe ArcIMS për të lehtësuar mbështetjen e hartave ndërvepruese përfshirë hartat gjeologjike, hartat e mineraleve, hartat e licencave dhe qasja në databazë për vendburimet minerale, licencat etj. Sistemi i menaxhimit të përmbajtjes mbështetet nga Magnolia për pjesën e të dhënave faktike për menaxhim më të lehtë të përmbajtjes. Mirëmbajtja e SMI GDK është e rëndësishme të plotësoj kërkesat që rriten dhe hosting dhe mirëmbajtjen e ueb faqes përfshirë azhurnimin dhe përmirësimin e softuerit.

Si detyrë kryesore e këtij projekti ka qene edhe bartja e websit-it nga kompania hartuese (Beak Consultants) tek KPM dhe trajnimi i stafit për mirëmbajtjen e këtij websit-i.

8.4 Menaxhimi i Qëndrueshëm i Resurseve Agregate - SARMa

KPM është vëzhguese në projektin SARMa - Menaxhimi i Qëndrueshëm i Resurseve Agregate. Ky projekt është realizuar nga Shërbimi Gjeologjik Slloven dhe partnerët e Evropës Juglindore.

Objektiv kryesor i projektit është që të zhvilloj qasje të përbashkët për planifikimin e menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve agregate (SARM), për të siguruar furnizimin efikas dhe të sigurt në Evropën Jug-Lindore. Objektivat specifike përfshijnë ngritjen profesionale, grumbullimin e informacioneve lidhur me gjendjen e sektorit dhe planifikimin për një Qendër Rajonale për SARM. Aktivitetet lokale, dhe të vendit do të përqendrohen në shfrytëzimin e resurseve minerale ndërtimore, të cilat nuk rrezikojnë ambientin me praktikën më të mira, duke reduktuar shfrytëzimin ilegal dhe me riciklimin për të reduktuar përdorimin e agregateve kryesore.

Ky projekt është i një rëndësie të veçantë për KPM dhe sektorin minerar në Kosovë si në aspektin e integritetit rajonal gjithashtu edhe për përfitimin e përvojave në fushën e shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve minerale ndërtimore-agregateve.

8.5 Mbështetje KPMM-se për kryerjen e Analizave Gjeokimike.

Ky projekt financohet nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në vlerë prej rreth 1 milion euro. Gjatë vitit 2009 janë kryer procedurat e publikimit të tenderit dhe zgjedhjes së kompanisë fituese. Të gjitha procedurat e prokurimit janë ushtruar nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, ndërsa implementimi i këtij projekti ka filluar në shkurt të vitit 2010 dhe do të zgjat 2 vite.

9. FINANCAT

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009 ka qen i ndarë në këto 5 (pesë) linja buxhetore si me poshtë.

Tabela 15: Aprovimi i buxhetit të vitit 2009

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2009
1	Mallra dhe Shërbime	586,148.00 €
2	Paga dhe Mëditje	491,447.00 €
3	Komunali	36,000.00 €
4	Subvencione	36,000.00 €
5	Projekte Kapitale	370,500.00 €
	Totali i Aprovuar	1,520,095.00 €




Figura 26. Aprovimi i buxhetit të vitit 2009

Ne tabelën e më poshtme kemi prezantuar buxhetin e aprovuar dhe të shpenzuar, po ashtu është paraqitur në përqindje shpenzimi i buxhetit, shih tabelën e në vijim.

Tabela 16: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2009, i shprehur në përqindje

Nr. Ren.	Përshkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Ndryshimi	Në %
1	Mallra dhe Shërbime	586,148.00 €	579,079.56 €	7,068.44 €	98.79
2	Paga dhe Mëditje	491,447.00 €	466,948.29 €	24,498.71 €	95.01
3	Komunali	36,000.00 €	28,282.34 €	7,717.66 €	78.56
4	Subvencione	36,000.00 €	29,261.50 €	6,738.50 €	81.28
5	Projekte Kapitale	370,500.00 €	366,194.24 €	4,305.76 €	98.84
	Totali i Aprovuar	1,520,095.00 €			
	Totali i Shpenzuar		1,469,765.93 €		
	Totali në %				96.69

Shpenzimet ne vijën buxhetore mallra dhe Shërbime janë paraqitur ne tabelën me poshtë.

Tabela 17: Buxheti i shpenzuar në Mallra dhe Shërbime në vitin 2009

Nr. Ren.	Përshkrimi	E Shpenzuar
1	Shpenzimet e Internetit	2,999.65 €
2	Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	14,904.43 €
3	Shpenzimet tjera telefonike - Vala 900	19,515.00 €
4	Vendim Gjyqi	4,048.00 €
5	Shërbimet Postare	57.50 €
6	Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit	22,760.69 €
7	Kontrollet Sistematike shëndetësore te stafit te terenit	2,000.00 €
8	Shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	10,725.00 €
9	Shërbimet tjera kontraktuale	37,948.20 €
10	Shërbimet teknike	920.00 €
11	Shërbimet për anëtarësim	828.80 €
12	Inventar për zyre	18,592.70 €
13	Kompjuterë	26,690.42 €
14	Harduer për teknologji informative	780.00 €
15	Pajisje tjera	33,438.97 €
16	Furnizim për Zyre (Material Hargjues)	14,294.45 €
17	Furnizim me ushqim dhe pije (reprezentacion)	857.50 €
18	Furnizim me veshmbathje (te mbrojtjes ne pune)	11,398.90 €
19	Tiketa Siguruese (Formular për printim për Kompani)	1,850.00 €
20	Karburant për ngrohje qendrore	7,793.53 €
21	Karburant për gjenerator	2,338.18 €
22	Karburant për Vetura	52,857.71 €
23	Avancë për para te gatshme (Peti keshi)	2,500.00 €
24	Avancë për vizita studimore dhe zyrtare	80,658.54 €
25	Regjistrimi dhe Sigurimi i automjeteve	12,598.85 €
26	Sigurimi i objektit	17,953.16 €
27	Servisimi i Automjeteve	31,401.58 €

28	Mirëmbajtja e ndërtesës	10,206.88 €
29	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	8,690.53 €
30	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	4,999.80 €
31	Qiraja	94,652.00 €
32	Reklama dhe konkurse	13,570.29 €
33	Botimet dhe publikimet	9,500.00 €
34	Dreka Zyrtare	4,748.30 €
	Totali	579,079.56 €




Figura 27. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar 2009

Ne tabelën vijuese janë të paraqitura pasqyrat e shpenzimeve Komunale

Tabela 18: Paraqitja e shpenzimeve sipas kategorisë ekonomike (Komunalit)

Nr. Ren.	Përshkrimi	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca
1	Rryma	15,000.00 €	14,921.29 €	78.71 €
2	Telefoni dhe faksi	19,500.00 €	11,683.40 €	7,816.60 €
3	Shpenzimet e Ujit	1,500.00 €	1,677.65 €	177.65 €
	Totali	36,000.00 €	28,282.34 €	7,717.66 €




Figura 28. Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar 2009

Ne vazhdim do ta paraqesim tabelën e Subvencioneve

Tabela 19: Paraqitja e shpenzimeve sipas kategorisë ekonomike (Subvencione)

Nr. Ren.	Përshkrimi	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca
1	Subvencione dhe Transfere	36,000.00 €	29,261.50 €	6,738.50 €
	Totali	36,000.00 €	29,261.50 €	6,738.50 €




Figura 29. Paraqitja e shpenzimeve sipas kategorisë ekonomike (Subvencione)

Ne vazhdim është prezantuar tabela e projekteve kapitale

Tabela 20: Paraqitja e shpenzimeve kapitale

Nr. Ren.	Përshkrimi	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca
1	Pajisje për Laboratorin Gjeologjik	40,000.00 €	39,689.49 €	310.51 €
2	Ndërtimi i dy plansheteve te Hartës Gjeologjike	53,700.00 €	53,700.00 €	€
3	Menaxhimi i Resurseve Minerale	96,300.00 €	96,280.00 €	20.00 €
4	Avancimi i Bazës se te Dhënave	50,000.00 €	49,010.00 €	990.00 €
5	Blerja e veturave	100,000.00 €	98,108.76 €	1,891.24 €
6	Softuer për Leximin e te Dhënave	15,000.00 €	14,999.99 €	0.01 €
7	Softuer për Personel dhe Logjistik	10,000.00 €	9,900.00 €	100.00 €
8	Fotokopje	5,500.00 €	4,506.00 €	994.00 €
	Totali	370,500.00 €	366,194.24 €	4,305.76 €




Figura 30. Paraqitja e shpenzimeve kapitale

Obligime te papaguara nga viti 2009 te cilat janë bartur për vitin 2010 kane mbetur 24,540.93 €, te detajuara janë paraqitur ne tabelën me poshtë.

Tabela 21: Obligimet e papaguara për vitin 2009

Obligimet e papaguara për vitin 2009		
Nr. Rendor	Përshkrimi	Shuma ne Euro
1	Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	1,266.25 €
2	Servisim I Automjeteve	4,041.27 €
3	Servisim I Gjeneratorit	185.00 €
5	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	1,230.70 €
6	Dreka Zyrtare	68.00 €
7	Vizitkarta për punëtorët e KPMM- se	89.00 €
8	Ujë Rugove	140.00 €
9	Karburant për vetura te KPMM-se	6,770.82 €
10	Karburant per Gjenerator te KPMM-se	1,112.60 €
11	Karburant për nxehtësi te KPMM-se	4,235.24 €
12	Shpallje ne Gazetë	1,191.32 €
13	Shërbimet postare për KPMM-ne	104.80 €
14	Sigurimi I ndotëses per KPMM-ne	1,479.63 €
15	Mirëmbajtja e ndërtesës për KPMM-ne	1,246.71 €
16	Shpenzimet e rrymës	1,379.59 €
Gjithsejtë		24,540.93 €

Paraqitja e Aktiviteteve të Divizionit të të Hyrave

Divizioni i të Hyrave gjatë vitit 2009 ka kryer detyrat duke u orientuar ne: Planifikim, mbledhje dhe menaxhim te të hyrave, vetëdijesimin dhe informimin e kompanive legale për respektimin e afateve të raportimit dhe pagesave për taniemë.

Gjatë vitit 2009 ka vazhduar zhvillimi i divizionit te te hyrave edhe me kompletimin procedurave për mbledhjen e te hyrave ne pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/3 dhe udhëzimet administrative, gjithashtu janë kryer edhe punë tjera me rëndësi.

Afatet per grumbullimin e te hyrave janë te ndara në:

TM1 (janar,shkurt,mars); raportohet dhe paguhet gjate muajit prill,

TM2 (prill,maj,qershor); raportohet dhe paguhet gjate muajit korrik,

TM3 (korrik,gusht,shtator); raportohet dhe paguhet gjate muajit tetor,

TM4 (tetor,nëntor,dhjetor); raportohet dhe paguhet gjatë muajit janar të vitit vijues në këtë rast vitit 2010.

Ku për secilin tremujor me afat deri me datën 30 te muajit vijues kompanitë e licencuara nga KPMM janë obliguar të bëjnë raportimin e sasisë se shfrytëzuar për mineralin e caktuar duke e shumëzuar me listën zyrtare te tantiemës, për këto ndryshime janë kontaktuar, informuar dhe këshilluar të gjitha kompanitë e licencuara dhe po ashtu janë pajisur me formular për raportim dhe pagese si dhe listën e tantiemës.

Ky informim dhe këshillim ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2009 edhe për kompanitë që janë pajisur ndërkohë me licencë të shfrytëzimit nga KPMM. Divizioni i të hyrave sipas Rregullores 2005/3 dhe Udhëzimeve Administrative në fuqi ka ekzekutuar faturat për gjobë administrative me qëllim të vetëdijesimit të bizneseve të licencuara nga KPMM kur është provuar se nuk kane respektuar ligjet ne fuqi.

Po ashtu Divizioni i të Hyrave është angazhuar shumë edhe në mbledhjen e borxheve nga vitet e kaluara, duke ju mundësuar kompanive që të futen në marrëveshje për pagesë të borxhit me këste mujore.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të dhënat lidhur faturimin dhe pagesat e realizuara gjatë vitit 2009.

Tabela 22: Faturat e lëshuara dhe të paguara në vitin 2009

Nr	Përshkrimi	Faturuar	Paguar	Bilanci
1	Minerale Metalike	904,974.44 €	732,622.58 €	172,351.86 €
2	Minerale Energjetike	1,808,700.23 €	2,231,752.13 €	-423,051.90 €
3	Minerale Ndërtimore	1,866,172.91 €	1,282,158.62 €	584,014.29 €
4	Gjoba Administrative	257,970.00 €	4,319.00 €	253,651.00 €
5	Taksa Administrative	395,519.40 €	205,881.05 €	189,638.35 €
Totali		5,233,336.98 €	4,456,733.38 €	776,603.60 €

Nga totali i përgjithshëm janë faturuar edhe kompanitë që kanë ushtruar veprimtari ilegale dhe u janë lëshuar gjoba administrative ne shumë prej 257,970.00 €.

10. AKTIVITETET E TJERA

10.1 GIS-i (Gjeo-databaza e te dhënave)

Ne baze te nenit 2.2. d. KPMM është përgjegjës edhe për krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për titullarët e mineraleve dhe të drejtave për shfrytëzimin e minierave, për t përbushur këtë funksion Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka Sistemin Informativ të Menaxhimit (SIM), Geo-Databazën e Kosovës (SIM, GDK) si Kadastër e minierave të Kosovës. GDK përkrah disa procese të punëve të KPMM-së, përfshirë menaxhimin dhe lëshimin e Licencave për Hulumtim, Shfrytëzim si dhe Lejeve për Punë të Posaçme.

Përveç kësaj, GDK menaxhon të gjitha të dhënat e KPMM-së të ruajtura në mënyrë elektronike (siç janë dokumentet dhe raportet, hartat gjeoshkencore, të dhënat e vendburimit mineral, arkivin dhe të tjera).

SIM- GDK përbëhet nga disa module që bashkëveprojnë me njëra-tjetrën. Komponentët kryesorë të sistemit janë: databaza Microsoft SQL Server 2000 me ArcSDE v 8.3, moduli për menaxhimin e të dhënave të ambientit, GUI që përbëhet nga VB. Basic. NET Rrjet gjithëpërfshirës, dhe ESRI ArcMap v 8.3 i rregulluar dhe aplikimi i objekteve të hartës ESRI.

Sektori mineral luan një rol kyç në rindërtimin e ekonomisë në Kosovë dhe perspektivat e të ardhmes së vendit. Një SIM i ri dhe që funksionon mirë, i cili u jep investitorëve qasje direkte në të dhënat e sektorit minerar, është një parakusht për mbarëvajtjen e mëtutjeshme të zhvillimit të sektorit minerar në Republikën e Kosovës.

SIM bën menaxhimin e ndryshimeve të kushteve të brendshme dhe të jashtme, siç janë strukturat administrative, legjislacioni, teknologjitë e zhvillimit të shpejtë të softuerit dhe harduerit, si dhe sasia e rritur shpejtë si të dhënave edhe të përdoruesve.

Përmes GIS-it, KPMM përveç që e përdor për nevoja të licencimit dhe të ofrimit të informatave investitorëve të interesuar, iu ofron informata edhe ministrive dhe komunave të Kosovës, siç janë MEM-i, MMPH etj., me të cilat iu ndihmon në hartimin e politikave zhvillimore dhe planifikimeve hapësinore.




Figura 31. Pamje nga Gjeo-databaza e KPMM-se

11. PROBLEMET NË SEKTORIN MINERAR

Aktivitetin e KPMM-së gjatë vitit 2009 e kanë shoqëruar disa vështirësi të cilat kanë ndikuar në efikasitetin e këtij institucioni mjaftë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Problemet e identifikuara gjatë punës së KPMM-së janë:

a. Skadimi i mandatit për 3 (tre) anëtarët e bordit

Nga data 28.07.2009 shumicës se anëtarëve të bordit Qeverisë ju kishte skaduar mandati, njërit me 30.04.2009, ndërsa dy të tjerëve përfshirë edhe kryesuesin me 28.07.2009. Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë njoftuar disa here mirëpo megjithatë kompletimi i bordit ka zgjatur deri me 1 shkurt 2010. Që nga kjo date kemi pasur një jofunksionim normal të institucionit ku ishin grumbulluar rreth 150 kërkesa për licenca dhe leje, mbi 30 ankesa të kompanive, etj, ky mosfunksionim i KPMM-se ka bllokuar shumë biznese në planifikimet e tyre për të zhvilluar dhe ka bllokuar shumë investime në sektorin minerar.

b. Shfrytëzimet ilegale dhe mosrespektimi i standardeve ambientale

Një prej shqetësimeve kryesore që është trashëguar nga vitet e mëparshme, për KPMM gjatë vitit 2009 kanë qenë edhe **operimet ilegale** të mineraleve ndërtimore dhe **mosrespektimi i standardeve ambientale** nga ana e kompanive të licencuara.

Operimet ilegale: çdo ditë e më shumë janë duke marrë përmasa më të mëdha në shkatërrimin e ambientit dhe shfrytëzimin e lëndëve të para minerale ndërtimore të një kualiteti të pakontrolluar dhe të një cilësie të ulët.

Inspektorati i KPMM-së vazhdimisht ka lëshuar dhe është duke lëshuar urdhëresa për ndërprerje të këtyre operimeve ilegale, mirëpo duke munguar fuqia ekzekutive e këtyre urdhëresave, operatorët ilegalë vazhdojnë operimin pa ndonjë shqetësim. KPMM vazhdimisht i ka përcjellë këto raste edhe në prokurori, mirëpo duke pasur parasysh afatet e shqyrtimit të këtyre lëndëve, kompanitë ilegale e kanë vazhduar punën përsëri pa u shqetësuar.

Efektet negative që janë duke shkaktuar operuesit ilegalë janë të shumëfishta, duke filluar nga:

- shkatërrimi i ambientit,
- ikja nga tatimi,
- ikja nga pagesa e Tantiemës ,
- konkurrenca jolojale ndaj kompanive të licencuara të cilat i kryejnë të gjitha obligimet ndaj shtetit të Kosovës,
- ofrimi i kualitetit të dobët dhe të pakontrolluar të materialeve për asfaltimin e rrugëve dhe ndërtimtarisë në përgjithësi,
- si pasojë e kualitetit të dobët të ofruar janë krijuar shpenzime të panevojshme të buxhetit të Kosovës në riasfaltim të rrugëve dhe mirëmbajtje të tyre, etj.

KPMM që nga janari vitit 2009 i ka dërguar Qeverisë një shkresë me të cilën ka kërkuar ndihmë për të ndaluar operimet ilegale, MEM-it, është njoftuar edhe Kuvendi i Kosovës, ndërsa ka pasur edhe iniciativa dhe përpjekje të vazhdueshme për këtë çështje, mirëpo ende nuk është arritur ndonjë rezultat i kënaqshëm.

Po ashtu, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/3 bëhet edhe lëshimi i gjobave administrative mbi veprimet ilegale, mirëpo këto gjoba nuk mund të ekzekutohen në mungesë të Ligjit të Procedurës Përmbartuese.

c. Mungesa e legjislacionit të kompletuar për sektorin minerar

Mungesa e legjislacionit të kompletuar për sektorin minerar është edhe një problem tjetër i cili KPMM-së vazhdimisht i shkakton vështirësi në kryerjen e punëve.

Finalizimi i Ligjit për Miniera dhe Minerale në mënyrë të mirëfilltë do të kishte mundësi që t'i evitohet të gjitha këto mangësi.

d. Koordinimi ndërinstitutional

Siç e kemi cekur edhe tek operimet ilegale, koordinimi ndërinstitutional është çelës për krijimin e rendit dhe implementimin e ligjit në sektorin minerar. Mungesa e një koordinimi të mirë po shkakton rritjen e operimeve ilegale, pamundësinë e implementimit të standardeve ndërkombëtare për mbrojtje të ambientit, pamundësinë e gjobitjes së operuesve ilegalë dhe pamundësinë e ndëshkimit të shkelësve të ligjit. Të gjitha këto po i inkurajojnë me të madhe aktivitetet e shkelësve të ligjit.

12. SYNIMET PËR TË ARDHMEN

a. Ndalimi i operimeve ilegale dhe ngritja e kualitetit të punës te kompanitë e licencuara

Një ndër synimet kryesore të KPMM-së për vitin 2010 është ndalimi i operuesve ilegalë në sektorin e minierave. Me ndalimin e operuesve ilegalë do të arrihet që të krijohet baza për ngritjen e kualitetit të punës te kompanitë e licencuara dhe do të rritej inkasimi i të hyrave për buxhetin e Kosovës.

Ndalimi i operimeve ilegale dhe zgjidhja e këtyre problemeve mendojmë që mund të bëhet në katër faza:

Faza 1: Qeveria do të duhej të merr vendim obligues për Policinë e Kosovës, që policia të ndalë dhe të legjitimojë të gjithë kamionët e ngarkuar me minerale ndërtimore (rërë, zhavorr, argjilë, gurë etj.) dhe të kërkojë nga ata të dëshmojnë që kanë një kopje të licencës nga KPMM-ja dhe një paragone po ashtu të vulosur nga KPMM-ja. Kamionët që janë ilegalë të konfiskohen menjëherë dhe të gjobiten.

Faza 2: Me inspektime të rregullta, të cilat realizohen në kompanitë poseduese të licencave do të arrihet deri te konstatimi i gjendjes ekzistuese mjedisore në vendet e operatorëve të licencuar për thyerjen, separimin dhe përpunimin materialeve gjeologjike ndërtimore. Pas marrjes së raporteve inspektuese në lidhje me gjendjen e kompanive të licencuara, kompanive të cilat nuk i plotësojnë standardet ambientale dhe nuk janë duke punuar në përputhje me kushtet e licencës do të intervenohet me masa shtrënguese që të bëjnë përmirësimet e nevojshme të parapara me ligje dhe standarde të aplikueshme në Kosovë.

Faza 3: Do të vazhdohet me hartimin e Planit të menaxhimit të resurseve minerale në Kosovë, që konsiston në faktin se Qeverisë (MEM) ti ofrohen propozime në hartimin e politikave të qarta për orientimin e shfrytëzimit nëpër zonat të cilat konsiderohen nga ekspertët si zona të përshtatshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive.

Faza 4: Të bëhet vlerësimi i shkatërrimeve në ambient nga operimet ilegale, përgatitja e projekteve për rehabilitim, hapja e fondit të rehabilitimit dhe fillimi i rehabilitimit.

Duhet theksuar edhe një herë se **çelës** për të krijuar rend në këtë sektor është ndalimi i operuesve ilegalë. Çdo iniciativë për t'i bllokuar kompanitë e licencuara pa bërë së pari ndalimin e operuesve ilegalë do të ishte një mbështetje edhe më e madhe e operatorëve ilegalë dhe një kontribut për të rritur numrin e operuesve ilegalë. Pra, është nevojë urgjente që sidomos faza e parë të fillojë së zbatuari menjëherë.

b. Rritja e koordinimit ndërinstytucional

Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional është e domosdoshme për të arritur respektimin e ligjit dhe standardeve tjera ndërkombëtare. Bashkëpunimi duhet të rritet kryesisht ndërmjet KPMM-së dhe prokurorive, policisë, MMPH-së, komunave, MPB-së etj.

c. Finalizimi i Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale

do të vazhdohet me grumbullimin e vazhdueshëm të të dhënave lidhur me resurset minerale në Kosovë, zonat e mbrojtura, të shpallura nga Qeveria dhe të aprovuara nga Kuvendi, monumentet e mbrojtura historike, kulturore, parqet nacionale, të dhënat gjeologjike mbi hulumtimet e kryera në të kaluarën, të cilat posedohen nga kompani shoqërore, arkiva etj. Qëllimi i mbledhjes së tërë këtyre informatave është që ato të futen në PMRM dhe të

bllokohen për licencim zonat e mbrojtura dhe zonat e tjera që janë në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë.